



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.70/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjekti Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.01.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, Anr.70/2025 e datës 22.01.2025.
- II. Subjektit politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijepesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datë 19.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë në të cilën pretendohet se kandidatët e këtij subjekti gjatë tubimit të mbajtur në Pejë, si dhe në programet televizive "CLICK" në Radio Televizionin 21 më datën 17 janar, si dhe në programin "N'Pikë" në televizionin DTV më datën 18 janar, janë evidentuar disa shkelje, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kodit të Mirësjelljes, Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto veprime përfshijnë përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI+, promovimin e përçarjes dhe frikës mes qytetarëve të Kosovës, si dhe nxitjen e urrejtjes përmes përmbajtjes gojore dhe vizuale.

Më tej në ankesë thuhet se gjatë tubimit të Koalicionit për Familje, të mbajtur në Pejë, në programin televiziv CLICK në Radio Televizionin 21 (i transmetuar edhe në Youtube) më 17

janar 2025, dhe në programin televiziv "N'Pikë" në televizionin DTV më 18 janar 202, janë bërë deklaratat publike nga kandidatët për deputetë Fatmir Smajli, Eman Rrahmani, Visar Korenica dhe Asdren Bytyqi, të cilat përmbajnë gjuhë diskriminuese, nxitje frike dhe urrejtje ndaj komunitetit LGBTI+.

Sipas parashtruesit të ankesës kandidatët e Koalicionit për Familje, kanë bërë disa deklaratat të cilat janë transmetuar drejtpërdrejt në rrjetin social Facebook deklaratat e kandidatit Smajli, deklaratat e kandidatit Rrahmani, në rrjetin social Youtube, si dhe transmetimi i deklaratave të kandidatëve Korenica dhe Bytyqi në televizionet RTV21 dhe DTV

Deklaratat e kontestuara në ankesë janë:

Deklarata e kandidatit Fatmir Smajli, i cili promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTI+ e përshkruan si "marrëzi" dhe "kundër natyrës njerëzore", duke përdorur një narrativë që sugjeron se këto të drejta përbëjnë një kërcënim për "ardhmërinë e shqiptarëve, pastaj në deklaratë pretendohet se "ideologjia" e partive dhe deputetëve të caktuar është kundër "formës natyrale të familjes shqiptare", duke nxitur përçarje dhe urrejtje mes qytetarëve të Kosovës.

Deklarata e kandidatit Eman Rrahmani, i cili promovimin e dashurisë mes personave LGBTI+ paraqitet si "turp", duke përdorur shembullin e Festivalit Anibar për të përhapur dezinformata dhe për të nxitur frikë ndaj komunitetit LGBTI+ dhe se angazhimi për të drejtat e këtij komuniteti është një kërcënim për traditat dhe kundër figurave historike të kombit shqiptar.

Deklarata e kandidatit Visar Korenica, i cili pretendon se të drejtat e komunitetit LGBTI+ janë "kundër natyrës njerëzore" dhe "nuk janë në interesin e përgjithshëm të shoqërisë".

Duke sugjeruar se politikat që mbështesin komunitetin LGBTI+ promovojnë "degjenerim" dhe paraqesin këto si kërcënim për sigurinë kombëtare, duke bërë lidhje të pabazuara me natalitetin dhe konfliktin potencial me Serbinë.

Deklarata e kandidatit Asdren Bytyqit, përmban gjuhë fyese dhe diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI+. Në debatin televiziv, ai e përshkroi institucionalizimin e të drejtave të këtij komuniteti si një kërcënim ndaj "familjes natyrale" dhe vlerave tradicionale, duke i quajtur "agjenda ultraliberale", që shkaktojnë "degjenerim" dhe "konfuzion" tek gjeneratat e reja. Për më tepër, me këtë deklaratë bëhet mohimi për të drejtën e komunitetit për të qenë të pranuar në hapësirën publike, duke e paraqitur ekzistencën e tyre si një devijim që duhet të kufizohet nga politika.

Sipas parashtruesit të ankesës këto deklaratat përbëjnë gjuhë urrejtjeje, nxisin stigmatizim dhe ndarje shoqërore duke i paraqitur personat LGBTI+ si kërcënim për rendin shoqëror dhe moral, minojnë dinjitetin e një grupi të marginalizuar dhe krijojnë një klimë armiqësore që mund të çojë në diskriminim dhe dhunë ndaj tyre.

Kërkojnë nga PZAP-i që të konstatojë shkeljen e LZP-së nga kandidatët e Koalicionit për Familje, të ndërmarr masa ndëshkuese si dhe Koalicioni për Familje, të kërkojë publikisht falje dhe të tërheqë deklaratat diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI+.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 21.01.2025, Koalicioni për Familje, e kundërshton ankesën e paraqitur ndaj tyre dhe kërkojnë që ajo të refuzohet, për arsye se kandidatët e po e tyre asnjëherë nuk kanë nxitur urrejtje apo mos durim mbi baza të orientimit seksual.

Në përgjigje në ankesë thuhet se të gjitha deklaratat e kandidatëve i referohen agjendës liberale, e cila mund të shtrihet në vendin tonë, dhe në këtë rast përmes miratimit të ligjeve të cilat Koalicioni për Familje i konsideron si të papranueshme, të panevojshme dhe si të padrejta. Lobimi dhe avokimi i Koalicionit për Familje, kundër martesave mes të njëjtit seks, është një e drejtë e cila buron edhe nga vetë përkufizimi i martesës si bashkësi mes një burri dhe një gruaje, sipas Ligjit për Familje, por gjithashtu është një e drejtë e cila buron nga Kushtetuta e Kosovës, e cila përcakton dhe definon këtë çështje në përputhje me ligjin.

Më tej në përgjigje theksohet se të drejtat e definimit të asaj se çfarë është martesa dhe mes kujt lidhet ajo, Kushtetuta ia derivon ligjit, ligji duhet të hartohet dhe të votohet nga përfaqësuesit e popullit — deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, secila parti politike ka të drejtë të llojë dhe të premtojë tek përfaqësuesit e saj qasjen e tyre politike lidhur me çdo ligj dhe çdo politikë që parashihet ose mund të prezantohet në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas tyre asnjëra nga deklaratat e kandidatëve nga Koalicioni për Familje nuk ka të bëjë me cenimin e të drejtave elementare të caktuara me Kushtetutë dhe ligj ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual. Më saktë, kjo ka të bëjë me moslejimin e disa të drejtave shtesë që nuk janë të garantuara as me Kushtetutë dhe as me ligj, dhe mes këtyre mund të jetë lidhja e martesës mes të njëjtit seks, adoptoni i fëmijëve, ndryshimi i gjinisë, soroogacia, fertilizimi i asistuar për gratë që dëshirojnë të lindin fëmijë pa burra — me donator anonim. Nuk ekziston asnjë lloj deklarimi që paraqet cenim të të drejtave të kësaj kategorie, shkurtim të tyre apo shprehje për ndryshimin e të drejtave kushtetuese që ata gëzojnë, përfshirë edhe lirinë e shprehjes dhe liritë e tjera që janë të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Deklarimi lidhur me përkufizimin e familjes në martesë si një lidhje mes një burri dhe një gruaje, adoptimin si një e drejtë ekskluzive të një çifti heteroseksual, ndryshimin e gjinisë si një akt i papranueshëm për ne si pjesë të shoqërisë, janë të drejta që i garantohen secilit qytetar apo secilit politikan që garon brenda kushteve të lejuara të një shoqërie demokratike.

Kërkojnë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ta refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtruar nga OJQ CEL Kosova dhe Dylberizimi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të artikullit/linkut të ofruar si provë materiale në ankesë <https://ëëë.facebook.com/koalicioniperfamiljen/videos/592906550158213e>, cila është bërë nga Koalicioni për Familjen, gjatë hapjes së fushatës në Pejë, ku shihet kandidati për deputet Fatmir Smajli, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të tije në Pejë ka përdorur fjalët “...me leju femrën e pamartuar me lind fëmijë e fëmijët kur të ju tekët më ndrru gjininë. Jo! Se unë unë besën po u ajepi se kurrë nuk do ta përkrähim këtë marri. Po a martohet more burri me burr e me metë shqipataria pa ardhmëri?! .... ndërsa kandidati për deputet nga kjo

parti Eman Rrahmani, ka deklaruar se: *“.. Anibarit [Festivalit Anibar] në Pejë ministria e komuna kanë jepë 300.000 euro me ju tregu Pejanëve se çka është dashnia: Mu martu burrë me burrë e gru me gru, me i tregu Pejës e Haxhi Zekës se po bojka me u martu burri me burrë e gruja me gru. Turp ju qoftë!”*.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 22.01.2025, ndërmoi hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjektit politik Koalicioni për Familjen ndaj LGBTI+ në tubimet zgjedhore në Pejë, me datë 17.01.2025, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë bërë në miting publik, audiencën, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmues ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidatet për deputet është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në fushatë zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje si dhe faktin që shkelja nga ky subjekt është bërë për herë të parë, njëherit subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr. 70/2025 më datë 22.01.2025

Kryesues i Panelit  
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.11/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Ragip Namani dhe Milena Gjeric, anëtarë, përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjekti Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.70/2025, të datës 22.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 29.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M


Hedhet si e pa lejuar ankesa e Subjektit Politik, Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.70/2025, të datës 22.01.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.70/2025, të datës 22.01.2025, ishte vendosur "I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, Anr. 70/2025 e datës 22.01.2025. II. Subjektit politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4.500 (katërmijepesëqind) euro. III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston





ligjshmërinë e tij për shkak siç thuhet në ankesë se; Vendimi është nxjerrë në kundërshtim parimet kushtetuese dhe ligjet ndërkombëtare dhe paraqet shkelje të lirisë së shprehjes duke propozuar që gjykata ta aprovoj ankesën si të bazuar, të 1. Të anulohet gjoba e vendosur ndaj Koalicionit për Familjet. 2. Të njihen deklaratat e Koalicionit si shprehje e mbrojtur politike sipas nenit 10 të KEDNj-së. 3. Të ri konfirmohet rëndësia e lirisë së shprehjes në nxitjen e debatit demokratik..

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.70/2025, të datë 22.01.2025.

Gjykata Supreme vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në drejtim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes ndaj ankesës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe konstatoi:

Ankesa e paraqitur kundër vendimit të Panelit (PZAP), A nr.70/2025 datë 22.01.2025 është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 19.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë në të cilën pretendohet se kandidatët e këtij subjekti gjatë tubimit të mbajtur në Pejë, si dhe në programet televizive "CLICK" në Radio Televizionin 21 më datën 17 janar, si dhe në programin "N'Pikë" në televizionin DTV më datën 18 janar, janë evidentuar disa shkelje, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kodit të Mirësjelljes, Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto veprime përfshijnë përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI+, promovimin e përçarjes dhe frikës mes qytetarëve të Kosovës, si dhe nxitjen e urrejtjes përmes përmbajtjes gojore dhe vizuale.

Në përgjigje në ankesë thuhet se të gjitha deklaratat e kandidatëve i referohen agjendës liberale, e cila mund të shtrihet në vendin tonë, dhe në këtë rast përmes miratimit të ligjeve të cilat Koalicioni për Familje i konsideron si të papranueshme, të panevojshme dhe si të padrejta. Lobimi dhe avokimi i Koalicionit për Familje, kundër martesave mes të njëjtit seks, është një e drejtë e cila buron edhe nga vetë përkufizimi i martesës si bashkësi mes një burri dhe një gruaje, sipas Ligjit për Familje, por gjithashtu është një e drejtë e cila buron nga Kushtetuta e Kosovës, e cila përcakton dhe definon këtë çështje në përputhje me ligjin. Më tej në përgjigje theksohet se të drejtat e definimit të asaj se çfarë është ~~martesa dhe mes~~





kujt lidhet ajo, Kushtetuta ia derivon ligjit, ligji duhet të hartohet dhe të votohet nga përfaqësuesit e popullit deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, secila parti politike ka të drejtë të llojë dhe të pretojë tek përfaqësuesit e saj qasjen e tyre politike lidhur me çdo ligj dhe çdo politikë që parashihet ose mund të prezantohet në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. PZAP kishte vendosur si në dispozitivin e vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar ankesën nga aspekti i lejueshmërisë dhe pranueshmërisë gjeti se ankesa është e lejuar. Duke u nisur nga fakti se ankesa është paraqitur kundër vendimit të PZAP A nr.70/2025 datë 22.01.2025, me të cilin është pranuar ankesa nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, dhe se Subjekti Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë është dënuar me gjobë prej 4,500.00€, ankesa është e pa lejuar, bazuar në nenin 118.4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku është parashikuar që "Vendimi i PZAP-së, mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës"

Pra me qenë se vendimi i PZAP –së i referohet gjobës e cila është më e vogël se limiti i përcaktuar sipas nenit 118.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, për këtë arsye Gjykata e hodhi poshtë ankesën si të palejuar.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë për arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 paragraf 4 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij akt vendimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.11/2025, me datë 29.01.2025.



Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

3   
Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik

Kryetari i kolegjit,  
Beshir Islami

Republic of the Philippines  
BAGUIO CITY  
BAGUIO CITY GOVERNMENT  
OFFICE OF THE CITY ENGINEER  
CITY ENGINEER  
BAGUIO CITY

\_\_\_\_\_



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.11/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Ragip Namani dhe Milena Gjeriq, anëtarë, përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjekti Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.70/2025, të datës 22.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 29.01.2025, merr këtë:

### A K T V E N D I M


Hedhet si e pa lejuar ankesa e Subjektit Politik, Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.70/2025, të datës 22.01.2025.

### A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.70/2025, të datës 22.01.2025, ishte vendosur "I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, Anr. 70/2025 e datës 22.01.2025. II. Subjektit politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4.500 (katërmijepesëqind) euro. III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston





ligjshmërinë e tij për shkak siç thuhet në ankesë se; Vendimi është nxjerrë në kundërshtim parimet kushtetuese dhe ligjet ndërkombëtare dhe paraqet shkelje të lirisë së shprehjes duke propozuar që gjykata ta aprovoj ankesën si të bazuar, të 1. Të anulohet gjoba e vendosur ndaj Koalicionit për Familjet. 2. Të njihen deklaratat e Koalicionit si shprehje e mbrojtur politike sipas nenit 10 të KEDNj-së. 3. Të ri konfirmohet rëndësia e lirisë së shprehjes në nxitjen e debatit demokratik..

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.70/2025, të datë 22.01.2025.

Gjykata Supreme vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në drejtim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes ndaj ankesës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe konstatoi:

Ankesa e paraqitur kundër vendimit të Panelit (PZAP), A nr.70/2025 datë 22.01.2025 është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 19.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, parashtuar kundër Subjektit Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë në të cilën pretendohet se kandidatët e këtij subjekti gjatë tubimit të mbajtur në Pejë, si dhe në programet televizive "CLICK" në Radio Televizionin 21 më datën 17 janar, si dhe në programin "N'Pikë" në televizionin DTV më datën 18 janar, janë evidentuar disa shkelje, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kodit të Mirësjelljes, Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto veprime përfshijnë përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI+, promovimin e përçarjes dhe frikës mes qytetarëve të Kosovës, si dhe nxitjen e urrejtjes përmes përmbajtjes gojore dhe vizuale.

Në përgjigje në ankesë thuhet se të gjitha deklaratat e kandidatëve i referohen agjendës liberale, e cila mund të shtrihet në vendin tonë, dhe në këtë rast përmes miratimit të ligjeve të cilat Koalicioni për Familje i konsideron si të papranueshme, të panevojshme dhe si të padrejta. Lobimi dhe avokimi i Koalicionit për Familje, kundër martesave mes të njëjtit seks, është një e drejtë e cila buron edhe nga vetë përkufizimi i martesës si bashkësi mes një burri dhe një gruaje, sipas Ligjit për Familje, por gjithashtu është një e drejtë e cila buron nga Kushtetuta e Kosovës, e cila përcakton dhe definon këtë çështje në përputhje me ligjin. Më tej në përgjigje theksohet se të drejtat e definimit të asaj se çfarë është martesa dhe mes





kujt lidhet ajo, Kushtetuta ia derivon ligjit, ligji duhet të hartohet dhe të votohet nga përfaqësuesit e popullit deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, secila parti politike ka të drejtë të llojë dhe të pretojë tek përfaqësuesit e saj qasjen e tyre politike lidhur me çdo ligj dhe çdo politikë që parashihet ose mund të prezantohet në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. PZAP kishte vendosur si në dispozitivin e vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar ankesën nga aspekti i lejueshmërisë dhe pranueshmërisë gjeti se ankesa është e lejuar. Duke u nisur nga fakti se ankesa është paraqitur kundër vendimit të PZAP A nr.70/2025 datë 22.01.2025, me të cilin është pranuar ankesa nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, dhe se Subjekti Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë është dënuar me gjobë prej 4,500.00€, ankesa është e pa lejuar, bazuar në nenin 118.4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku është parashikuar që "Vendimi i PZAP-së, mund të ankimohej në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës"

Pra me qenë se vendimi i PZAP –së i referohet gjobës e cila është më e vogël se limiti i përcaktuar sipas nenit 118.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, për këtë arsye Gjykata e hodhi poshtë ankesën si të palejuar.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë për arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 paragraf 4 të LJP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij akt vendimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.11/2025, me datë 29.01.2025.



SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

3

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami

Department of Health and Human Services  
U.S. Department of Health and Human Services  
45 CFR 101.11.1  
OFFICE OF THE ASSISTANT SECRETARY FOR  
REGULATORY AFFAIRS